

VENDIM
Nr. 793, datë 12.12.2022

PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 26, DATË 20.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT/RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKITË KAMZË DHE KAVAJË DHE ÇAKTIMIN E TYRE SI NJËSI ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 26, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, në Bashkinë Kamzë, në masën 13 272 319 (trembëdhjetë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e çerdhes “Kamzë”, i cili i transferohet Bashkisë Kamzë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

b) Në pikën 3, fjalët “... sipas pikave 1 dhe 2 ...” zëvendësohen me “... sipas pikave 1, 2, 2/1 dhe 2/2 ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku